



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 325, datë 22.07.2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 643,
DATË 23.12.2020 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE STANDARDE PËR
ORGANIGRAMËN, PËRSHKRIMIN E DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË
KATEGORIVE PUNONJËSVE TË GJYKATËS SË LARTË”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, në nenet 113 e 117, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 89, 94, pika 1 dhe 3 dhe nenin 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I :

Në Vendimin nr. 643, datë 23.12.2020, “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në lidhjen 2, Përshkrimi standard i detyrave dhe i përgjegjësive për secilën kategori të punonjësve të Gjykatës së Lartë, për pozicionin këshilltar ligjor, kapitulli XII. Kritere të veçanta, ndryshohet si më poshtë:

- a) Në nënndarjen, “Përvoja”: numri “10” zëvendësohet me numrin “5”;
- b) Në nënndarjen “Aftësi të tjera”: fjalia “*të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës*” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR